



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 04.03.2020

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve zhvillim konsultime , të cilat janë të detyrueshme për gërmën “e” të nenit 54, të këtij ligji.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak me shkresë nr. prot 2811, datë 25.02.2020 të Projekt-Vendimit “*PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN”, TË DY AMBJENTEVE: S1 = 79.1M² DHE S2 = 90.4 M², TË NDODHURURA NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR. PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJIA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 3 VJET, PËR T’U PËRDORUR: “PËR SHËRBIME DHE MBËSHTETJE SOCIALE E KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE; PËR NISMA NË MBËSHTETJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE, ARSIMIT, EDUKIMIT, PUNËSIMIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PËR INFORMIMIN, NDËRGJEGJËSIMIN, INTEGRIMIN, BASHKËJETESËN KOMUNITARE DHE DIALOGUN SOCIAL”, të propozuar nga Zëvendëskryetari i Bashkisë Durrës, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.*

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail: keshillidurres@gmail.com, ose me shkresë pranë protokollit të Bashkisë Durrës, brenda 20 ditëve punë nga publikimi në faqe zyrtare të Bashkisë Durrës.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja